3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODER**

# KËRKESË

"PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS PREVENTIVE"

*PARA;* GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR

**SHKODËR**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër,mbi bazen e informacioneve të ardhura nga shërbimet e policisë gjyqësore, ka regjistruar procedimet penale Nr. 109/2018, për vepren penale të parashikuar nga neni 287 të KP.

**Nga studimi i akteve të këtij procedimi rezulton se;**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, në mënyrë te pavaruar për të njejtin objekt hetimi ka regjistruar procedimet penale Nr. 109/2018 (per referimin e DVP Shkoder) dhe Nr. 428/2018 (në bazë të referimit të Njesise Hetimore se Taks Forces Speciale Qendrore), të cilat pas nje analize ne drejtuesin e prokurorise, më datën 12.03.2018, me vendim të titullarit kësaj prokurororie u bashkuan ne nje procedim te vetem, në atë me numër **109/2018** për veprën penale të "**Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**", parashikuar nga **neni 287 i Kodit Penal**, per te cilen u deleguan veprime hetimore me urdher delegimi per oficeret e policise gjyqesore Çezar Keçi dhe Pjerin Lazri.

Nga komunikata zyrtare e Policisë në Republikën e Malit të Zi ka rezultuar se zyrtarët e policisë të departamentit për luftimin e drogave në bashkëpunim me Prokurorinë Speciale të Shtetit, kanë hetuar prej muajsh një grup kriminal dhe kane realizuar operacionin policor të quajtur "Mashtrim" (Trick), gjatë të cilit kanë konfiskuar një sasi prej 982 kg marijuanë, 1.7 kilogram heroinë dhe rreth 3 kg përzierës dhe kanë arrestuar 12 persona. Përkatësisht, oficerët e policisë më 17 Dhjetor 2017, rreth orës 16.00, kanë arrestuar shtetasin shqiptar Ndue Vasel Pepaj, si kreun e organizates kriminale që vepronte në Mal të Zi dhe që merrej me trafikimin dhe shitjen e lëndës narkotike.

Sipas policisë malazeze, kjo organizatë kriminale dyshohet se kishte vepruar për një periudhë të gjatë kohore dhe veçanërisht aktive ka qenë që nga 01.01.2016, në trafikimin dhe shitjen e lëndëve narkotike në nivel ndërkombëtar.

Nga komunikimi me Drejtorinë për Narkotikët dhe Trafiqet ne Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka rezultuar se operacioni i kryer ne Republikën e Malit të Zi, ishte operacion i përbashkët mes dy policive dhe prokurorive respektive.

Duke marrë në konsideratë:
-faktin e ushtrimit të aktivitetit kriminal ndër vite në fushen e trafikimit ndërkombetar të lëndëve narkotike të shtetasit Ndue Pepaj,
- faktin që ky shtetas si pasoje e aktivitetit të tij kriminal gjithashtu ka përfituar pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, të cilat me pas i ka shitur tek të afërmit e tij ndërkohë që të ardhurat prej tyre përsëri administrohen nga familjarët e shtetasit Ndue Pepaj,
-faktin që Ministria e Drejtësisë në bazë të nenit 14 të Ligjit Nr. 10193, dt 03.12.2009 "Për Marëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çeshtjet Penale" i ka dhënë rrugë letërporosisë së prokurorisë Speciale Shtetërore, për kryerjen e veprimeve në lidhje me me këtë shtetas, i cili akuzohet në Mal të Zi për veprat penale të "Krijimit të Organizatës Kriminale" si dhe "Prodhimit dhe vënies në qarkullim të paautorizuar të drogave narkotike", parashikuar nga nenet 401/a paragrafi 1 qe ka lidhje me paragrafin 6 si dhe 401/a paragrafi 2 qe ka lidhje me paragrafin 6, dhe nenit 300 të Kodit Penal të Malit të Zi, me qëllim të kryerjes të një hetimi të hollësishëm të orgjinës të këtyre aseteve dhe transferimit të tyre nepermjet transaksionesh të njepasnjeshme shitjeje, strukturat e DVP Shkoder dhe ato të Njesise Hetimore te Taks Forces Speciale Qendrore, ne menyre te pavaruar nga njera tjetra i kanë kerkuar Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare Shkoder regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve:

1. **Ndue Pepaj**, i biri i Vasel dhe i File, i datëlindjes 06.07.1989, lindur dhe banues në Hot te Bashkisë Malësi e Madhe, aktualisht i arrestuar në Republikën e Malit të Zi, për trafikim narkotikësh,
2. **Gjergj Tatiqaj**, i biri i Kol dhe i Diell, i datëlindjes 30.10.1963, lindur në Goraj-Shkodër dhe banues në Britaninë e Madhe.
3. **Mikel Livalli**, i biri i Pale dhe i Age, i datëlindjes 20.06.1972, lindur në Ndreaj-Shkodër dhe banues në Hot Shkoder.
4. **Luçe Livalli**, e bija e Vasel dhe e File, e datëlindjes 01.05.1981, lindur dhe banuese në në Hot Shkoder.

**Nga kryerja e veprimeve të mëtjeshme hetimore ka rezultuar se:**
Shtetasi Ndue Vasel Pepaj, në shkurt të vitit 2012 është evidencuar në Kartotekën për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, per tendencën e trafikimit të narkotikëvë, në drejtim të Republikës së Malit të Zi.
Shtetasi në fjalë, ne nje siperfaqe te konsiderueshme toke perfituar nga Ligji nr 7501 date 19.7.1991 ka ndërtuar nje **objekt te madh dy katësh luksoz në Bajzë** të Bashkisë Malësi e Madhe, ku kati i parë është **Bar Restorant**, ndërsa kati i dytë **Hotel**. Po ashtu në te njejten siperfaqe jane ne funksionim edhe disa sherbime te tjera qe sherbejnë si **Lavazh dhe Tabcco Shoop** (dyqan cigaresh). Gjithashtu, shtetasi Ndue Pepaj ka **një banesë 3-katëshe ne lagjen Lulashpepaj**, të Njësisë Administrative Kastrat, në Bashkinë Malësi e Madhe.
Nga kërkimi në Sistemin e ALUIZNIT, sipas pergjigjies Nr. 26/1 date 26.01.2018, rezulton që shtetasi Ndue Pepaj bashke me kunatin dhe motrën e tij, shtetasit Mikel dhe Luçe Livalli të ketë bërë tre vetëdeklarime, përkatësisht me kod unik nr.8153147;

8172244 dhe 8261607, per tre ndërtime informale këto të ndërtuara në Njësine Admistrative Kastrat, Malësi e Madhe.
Gjithashtu nga kërkimi në Sistemin "E-Gjoba" të Policisë së Shtetit, në emër të shtetasit Ndue Vasel Pepaj, janë të regjistruara 5 automjete, dy Mercedez Benz, dy Ëolksëagen dhe një Renault, të cilat sipas pergjigjies nr 325/1 date 23.01.2018 ne pronesi te shtetasit Ndue Vasel Pepaj, në Shkoder rezultojne automjetet me targat:

- Ëolksëagen Golf, Prodh 2006 me targe **AA 141 KR**, leja qarkullimit date 24.11.2014 çmimi i blerjes deklaruar 1220,18 Euro dhe pagesa e doganes vlera 99.990 leke.
- Renault Kangoo me targe **AA 120 LK**; leja qarkullimit date 17.04.2015, çmimi i blerjes deklaruar 1500 Euro dhe pagesa e doganes vlera 80.119 leke.
- AA 188 LO; dosja transferuar ne Tirane me date 01.11.2016.
- Mercedes Benz, Prodh 2002, me targe **AA 999 PR** , leja qarkullimit date 06.03.2017 çmimi i blerjes deklaruar 3500 Euro dhe pagesa e doganes vlera 98.199 leke, aktualsiht sekuestruar ne kuader te procedimit penal nr 1819/2017.
- Ndersa automjeti me targe AA 494 RA nuk i perket shtetasit Ndue Vasel Pepaj.

Nga verifikimet e kryera me Drejtorine e Përgjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave, ne pergjigjien e saj te dates 06.03.2018, informohemi per perfshirje ne dy transaksione bankare te shtetasit Ndue Vasel Pepaj ne shitblerje makinash ne vleren 1 000 000 Leke dhe 10 000 Euro ne vitet 2013 dhe 2014, veprime te kryera tek noteret Luljeta Cenaj (Nr 157/111) dhe Vasil Martini (2872/1969). (Duhet sekuestrohen praktikat tek noterja).
Gjithashtu, ne pergjigjien e dates 27.03.2018 te DPPPP me interes paraqiten transaksionet financiare te shtetasit:

- **Mikel Pale Livalli** arketim ne llogarine nr 222 BA 1122000 ne BKT ku jane derdhur 47 100 Euro si para te ***<u>ardhura nga emigracioni</u>*** dhe qe do perdoren per blerje garazhdesh dhe dyqani tek noteri Valbona Hajdari; si dhe terheqie ne llogarine nr AL 60202510020000000020960850 te Raiffesisen Bank ne shumat 40 000 Euro dhe 50 749 Euro per tjatersim pasurie te paluajtshme,
- **Vasel Pepaj**, per shitjen e automjeti ne vleren 3 000 000 leke veprim e kryer tek noteri Sabri Kurtaj
- **Sokol Dede Prendi** per blerjen e trualli dhe ndertese ne vleren 10 195 780 leke veprime te kryera tek noteri Prenge Zefi.

Me daten 26.03.2018 i eshte kerkuar Oficerit te Kontaktit te NCA te Ambasades se Britanise se Madhe, informacion mbi shtetasin Gjergj Tatiçaj. Ne daten 24.04.2018 eshte administruar pergjigjia e ardhur nga Oficeri i Kontaktit te NCA te Ambasades se Britanise se Madhe, informacion mbi shtetasin Gjergj Tatiçaj ku percaktohet adresa e tij ne Mbreterine e Bashkuar, 7 Columbia Avenue, Edgëare, Middlesex, London HA85DQ, ai figuron i denuar ne vitin 2009 per drejtim automjeti ne gjendje te dehur; ne Mars 2006 eshte bere drejtor i kompanise GKT Construction me adrese , 7 Columbia Avenue, Edgëare; llogari bankare te hapur ne vitin 2005, nje llogari bankare UK Halifax te hapur ne 2007 dhe nje karte kresiti MBA Ltd qe nga 2004. Po ashtu ne kete pergjigjie gjithashtu thuhet se Ne Mars 2006 Lule Tatiqaj është bërë Sekretare e Kompanisë.

REPUBLIKA E SHQIPERISË PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR SEKRETARIA

Nga pergjigjja nr 1436 date 19.03.2018 qe ZVRPP Malesi e Madhe e ka derguar Prokurorise Shkoder ka rezultuar se ne baze te ligjit nr 7843 date 13.07.1994, shtetasi **Vasel Dod Pepaj** banor i fshatit Hot:
Ne zonen kadastrale 1964 me Urdher nr 20 date 31.01.**2005** te ZRPP Malesi e Madhe ka regjistruar pasurine **nr. 731** ZK. 1964 me **siperfaqe 70 metra** katrore. Kete siperfaqe toke ai e ka perfituar nga Ligji nr 7501 date 19.7.1991, sipas AMTP te dates 17.01.2005 dhe konkretisht ai ka perfituar pasurine **Nr.729/1** si pemtore me siperfaqe **1190** metra katrore dhe pasurine. **Nr.731** si toke are ne siperfaqe **70 metra** katrore.
Me date 21.01.2005 sipas deklerates personale te kryer para noterit ( Rep 224 dhe Kol 92 date 31.01.2005) shtetasi Vasel Dod Pepaj (babai i shtetasit Ndue Pepaj) ka deklaruar se pasurite:

- Nr. 715 me sip toke are 2698 meta katrore dhe
- Nr. 729 me siperfaqe pemetore 6320 metra katrore

dhene atij nga komisioni i ndarjes se tokes ne fshatin Hot, nuk jane te tijat, nuk administrohen prej tij dhe se nuk kishte pretendime mbi ate pronesi dhe ka kerkuar qe keto siperfaqe tojke te kthehen ne favor te shtetit.
Me Urdher nr 01 date 23.10.2014 te regjistruesit Aleksander Shytani eshte vendosur ndarja e pasurise: **Nr. 729/2, ZK Nr. 1964 prej 6320 metrash katrore** ne dy pasuri ne ate **Nr. 729/3** me siperfaqe **1810 metra** katrore dhe ate **Nr. 729/4** me siperfaqe **4510 metra** katrore.
Me Urdher nr 0155 date 23.10.2014 te regjistruesit Aleksander Shytani eshte vendosur te regjistrohet ne emer te shtetasit Ndue Vasel Pepaj **pasuria nr. 729/4,** Pemtore Z.K 1964 me **siperfaqe 4510 metra** katrore, mbeshtetur AMTP nr 77 date 14.05.2007 per **pasurine nr.729/2(2)** me siperfaqe **4510 metra** katrore.
Ne date 28.07.2015 shtetasi Ndue Vasel Pepaj dhe bashkeshortja e tij Jonida Agostin Pepaj me kontrate noteriale shitblerje Nr. 4130 Rep, Nr 2866 Kol, i kanë shitur kunatit, shtetasit Mikel Pal Livalli:

- Pasurine **Nr. 120/3 ZK 1989** pemtore te ndodhur ne Ivanaj me **siperfaqe 4707 metra** katrore per shumen 743 706 leke
- Pasurine Nr. **120/2 ZK 1989**, truall + ndertese te ndodhur ne Ivanaj me siperfaqe totale **600 metra** katrore nga e cila **ndertese 315,5 metra** katrore dy kat, per shumen 5 200 000 leke.

Me Dekleraten Noteriale Nr. 4436 Rep dhe Nr.3107 Kol date 14.08.2015 shtetasi Ndue Vasel Pepaj deklaron se heq dore me cilesine e aplikuesit prane ALUIZNIT Shkoder me Nr. 12 798 Prot date 21.01.2015 per ndertim e tj pa leje mbi pronen Pemtore me siperfaqe 4707 metra katrore te ndodhur ne Ivanaj, Malesi e Madhe.
Ne daten 16.08.2017 shtetasi Mikel Pal Livalli dhe bashkeshortja e tij shtetasja Luçe Vasel Livalli me kontrate noteriale shitblerje Nr. 5047 Rep, Nr 3691 Kol, i kanë shitur shtetasit Gjergj Kol Tatiqaj i datl 30.10.1963, lindur ne Tuz dhe banues ne Mbreterine e Bashkuar:

- Pasurine **Nr. 120/4 ZK 1989** Truall+ Ndertese me **siperfaqe 89.9 metra** katrore, (perfituar me proces legalizimi sipas deklerates me indeks nr. 8261607 date 30.04.2015; akt kualifikimi 6510 date 02.09.2015; vendim 3867 date 04.09.2015; leje legalizimi 93759 dt. 28.09.2015) per çmimin 2.548.665 leke

Ne daten 16.08.2017 shtetasi Mikel Pal Livalli dhe bashkeshortja e tij shtetasja Luçe Vasel Livalli me kontrate noteriale shitblerje Nr. 5048 Rep, Nr 3692 Kol, i kanë shitur

REPUBLIKA E SHQIPERISE PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE SHKODER SEKRETARIA

7

shtetasit Gjergj Kol Tatiqaj i datl 30.10.1963, lindur ne Tuz dhe banues ne Mbreterine e Bashkuar:

- Pasurine **Nr. 120/5 ZK 1989** Truall+ Ndertese 1 kat me **siperfaqe 37.8 metra** katrore, (perfituar me proces legalizimi sipas deklerates me indeks nr. 8261607 date 30.04.2015; akt kualifikimi 6512 date 02.09.2015; vendim 3869 date 04.09.2015) per çmimin 1.071.630 leke

Ne daten 16.08.2017 shtetasi Mikel Pal Livalli dhe bashkeshortja e tij shtetasja Luçe Vasel Livalli me kontrate noteriale shitblerje Nr. 5049 Rep, Nr 3693 Kol, i kanë shitur shtetasit Gjergj Kol Tatiqaj i datl 30.10.1963, lindur ne Tuz dhe banues ne Mbreterine e Bashkuar:

- Pasurine **Nr. 120/6 ZK 1989** pemetore me **siperfaqe 4579.3 metra** katrore per çmimin 2.000.000 leke

Ne daten 16.08.2017 shtetasi Mikel Pal Livalli dhe bashkeshortja e tij shtetasja Luçe Vasel Livalli me kontrate noteriale shitblerje Nr. 5050 Rep, Nr 3694 Kol, i kanë shitur shtetasit Gjergj Kol Tatiqaj i datl 30.10.1963, lindur ne Tuz dhe banues ne Mbreterine e Bashkuar:

- Pasurine **Nr. 118/1 ZK 1989** pemetore ndodhur ne Ivanaj me **siperfaqe 1088 metra** katrore per çmimin 440.000 leke

Ne daten 16.08.2017 shtetasi Mikel Pal Livalli dhe bashkeshortja e tij shtetasja Luçe Vasel Livalli me kontrate noteriale shitblerje Nr. 5051 Rep, Nr 3695 Kol, i kanë shitur shtetasit Gjergj Kol Tatiqaj i datl 30.10.1963, lindur ne Tuz dhe banues ne Mbreterine e Bashkuar:

- Pasurine Nr. **120/2 ZK 1989**, truall + ndertese te ndodhur ne Ivanaj me siperfaqe totale **600 metra** katrore nga e cila **ndertese 315,5 metra** katrore dy kat, per shumen 7 800 000 leke.

Në pergjigjjen Nr 286/1 datë 12.01.2018 e Drejtorise Rajonale Tatimore Shkodër thuhet se sipas kërkimit ne sistemin informatik C@ts rezulton:

- Shtetasi **Ndue Vasel Pepaj** me numer personal I90706039A është regjistruar si **Fermer, Prodhues Bujqesor** pa pergjegjesi tatimoreme NIPT L78426773R.
- Shtetasja **Jonida Agostin Pepaj** me numër personal J45818048Ë është regjistruar si **Fermer, Prodhues Bujqësor** pa përgjegjësi tatimore me NIPT L78225771S.
- Shtetasi **Gjergj Tatiqaj** me numer personal 533918961 rezulton te jetë regjistruar si :
  **1**. Person fizik me emrin tregtar "**Cavaliero 2017**" me NIPT L78223702G me objekt veprimtarie "**Bar-Restorant**" me adrese Bajze Rr Nacionale "Shkoder Hani i Hotit" godine 2-kateshe, kati pare, pasuria nr. 120/2, zona kadastrale nr. 1989, Kastrat Malesi e Madhe; si dhe **2.** Person fizik me emër tregtar "Gjergj Tatiqaj" me NIPT L78223702G me aktivitet "**Hotel-Lavazh-Tabacco**" me adrese Bajze Rr Nacionale "Shkoder Hani i Hotit" godine 2-kateshe, kati dyte, pasuria nr. 120/2, zona kadastrale nr. 1989, Kastrat Malesi e Madhe.

Nga pergjigjja Nr 2727/1 datë 27.03.2018 e Drejtorise Rajonale Tatimore Shkodër rezulton se me emrat tragetar CAVALIERO jane regjistruar subjeketet e meposhtme:

- Me emrin tregtar "**Cavaliero 2017**" rezulton te jete i regjistruar subjekti **Gjergj Tatiqaj** si person fizik, identifikuar me NIUS L78223702G me perfaqesues ligjor Gjergj Tatiqaj me objekt veprimtarie "**Bar-Restorant**" nuk ka detyrime te

REPUBLIKA E SHQIPERISE PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE SHKODER SEKRETARIA

mbartuara ne kohe reale. Sipas deklerates se Tatim Fitimit te Thjeshtuar 2017 te ardhurat e deklaruara janë 169 890 leke.

- Me emrin tregtar "**Cavaliero**" rezulton te jete i regjistruar subjekti **Luçe Livalli** si person fizik, identifikuar me NIUS L67511702V me perfaqesues ligjor Luçe Livalli me objekt veprimtarie "**Hotel-Lavazh-Tabacco**" nuk ka detyrime te mbartuara ne kohe reale. Subjekti aktualsiht është me status Kerkese per Çrregjistrim duke filluar nga data 21.08.2017. Sipas deklerates se Tatim Fitimit te Thjeshtuar 2016 te ardhurat e deklaruara janë 770 222 leke dhe per vitin 2017 janë 1 177 899 lekë.
- Subjekti **Mikel Livalli** person fizik, identifikuar me NIUS L67508701V me perfaqesues ligjor Mikel Livalli me objekt veprimtarie "**Bar-Restorant**" nuk ka detyrime te mbartuara ne kohe reale. Subjekti aktualsiht është me status Kerkese per Çrregjistrim duke filluar nga data 21.08.2017. Sipas deklerates se Tatim Fitimit te Thjeshtuar 2016 te ardhurat e deklaruara janë 4 903 590 leke dhe per vitin 2017 janë
2 693 020 lekë.

Nga pergjigjiet pozitive me interes të kthyera nga disa nga Bankat e Nivelit te Dytë rezulton se nga :

- Shkrese nr. 348/3 date 06.02.2018 e derguar nga Drejtoria e Pergjithshme e BKT-se Tiranë pershkruhen dy kreditime pozitive në llogarine perfituese me nr. **517001234** te shtetases **Jonida Pepa** shoqeruar me kryerjen e transaksioneve te datave 13.09.2017 dhe 10.11.2017 sipas faturave tatimore nr. 423 dt 06.09.2017 dhe nr.533 dt 16.10.2017, te shitjes se nje sasie prej 8462 kg **sherebele** me vlere **1 100 060 leke** dhe sasise 1219 kg **sherebele** me vlere **121 900 leke** tek subjekti grumbullues **"Muçaj"Shpk** me NIPT L78225771S me perfaqesues shtetasin Vasel Muçaj.

- Shkrese nr. 348/1 date 26.01.2018 e derguar nga Drejtoria e Pergjithshme e BKT-se Tiranë pershkruhen numrat e llogarive bankare dhe gjendja per shtetasit:

  **- Ndue Vasel Pepaj** llogari rrjedhese BKT Nr. **517739131**, çelur me date 16.12.2013 me gjendje aktuale **50,102**.74 **lek** dhe 9.00 Euro,

  **- Jonida Agostin Pepaj** llogari rrjedhese BKT Nr. **517001234,** çelur me date 31.08.2017 me gjendje aktuale **1,216,540**.25 **lek** dhe 0.00 Euro,

  **- Agostin Lek Kacaj** i datelindjes 17.09.1964 llogari rrjedhese BKT Nr. **517000201,** çelur me date 03.03.2016 me gjendje aktuale **143,262**.00 **lek,**

- Shkrese nr. 2479/1 date 25.01.2018 e derguar nga Drejtoria e Pergjithshme e **Raiffeisen BANK** Tiranë pershkruhen numrat e llogarive bankare dhe gjendja per shtetasit:

  **- Vasel Dod Pepaj** llogari rrjedhese Raiffeisen Nr. **9201943714** ne lek, aktualsht e mbyllur, ne te cilen me date 16/04/2009 eshte kredituar vlera 13,500.00 leke nga nje kontrate qeraje paguar nga DALEKOVOD D.D ZAGREB, Dega Tirane, shume kjo e terhequr me date 19/05/2009 nga shtetasi Vasel Pepaj.

  **- Ndue Vasel Pepaj** llogari rrjedhese Raiffeisen Nr. **0020943668**, ne lek me gjendje zero dhe Raiffeisen Nr. **0020943668**, ne Euro me gjendje zero.

  **- Gjergj Kol Tatiqaj** llogari rrjedhese Raiffeisen Nr. **0001297300**, ne lek me gjendje 1,400 leke dhe Raiffeisen Nr. **0001297300**, ne Euro me gjendje zero.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR SEKR.

**- Gjina Kole Kacaj** e datelindjes 25.09.1972, llogari page Raiffeisen Nr. **0001250895** ne leke me gjendje aktuale **219,764**.32 **lek**

- Shkrese nr. 8832/1 date 20.03.2018 e derguar nga Drejtoria e Pergjithshme e Raiffeisen BANK Tiranë përshkruhen numrat e llogarive bankare dhe gjendja për shtetasit:

  **- Mikel Pale Livalli** eshte klient i bankes me "numer personal" **960850,** llogari ne te cilat vihet re nje kreditim periodik i shumave **4,994.00** leke nga urdheruesja **Lule, Zoje** dhe **Rudine Tatiqaj** si dhe **Hame Markvukaj**.

  **- Luçe Vasel Livalli** ka qene kliente e bankes me "numer personal" **B88115** e cila figuron e mbyllur dhe po ashtu kjo kliente nuk ka kryer asnje veprim bankar.

  **- Sokol Dede Prendi** i datl 10.04.1987 është klient i bankës me "numër personal" **B38396,** llogari ne te cilen ka bere nje derdhje dhe kryesisht ka kaluar paga e tij.

- Shkrese nr.18/01122/tbo-002 date 26.01.2018 e derguar nga Drejtoria e Pergjithshme e SOCIETE GENERALE ALBANIA Tiranë përshkruhen numrat e llogarive bankare dhe gjendja për shtetasit:

  **- Ndue Vasel Pepaj** llogari rrjedhese Nr. **00001198237**, ne lek, celur me date 05.05.2014 **me gjendje 60,776.02 leke**. Ne veprimet e pasqyruara per vitet 2015-2015 ka kryesisht kalim page mujore nga thesari ne shumen 30.740 leke, vlen per tu theksuar nje **transferte e dates 05.10.2015 nga Italia** nga CORD-NET ITALIA S.R.L Sipendio 08/15 **Shtogaj David** ne shumen 177.726,90;

  **- Gjina Kol Kaçaj** ka qene kliente e bankes me llorai rrjedhese ne leke me Nr.00001267545 hapur ne 18.03.2015 dhe mbyllur me 02.03.2016.

  **- Agostin Lek Kacaj** është administrator ne kompanine **Fermeri Agostin Kaçaj**.

Gjithashtu, nga korespondenca me kompanite celulare VODAFONE SHA, ALBETECOM-EAGLE dhe TELCOM ALBANIA jane identifikuar si numra teklefonikë celularë me interes ne perdorim nga shtetasit Ndue Pepaj, Vasel Pepaj, Mikel Livalli, Luçe Livalli, Gjergj Tatiçaj, Jonida Pepaj. Me shkresë nr.2446/1, prot, datë 07.05.2018, të Telekom Albania rezulton se numri i telefonit 0684622262, është i regjistruar në emër të Ndue Pepaj, ID-Z2174866, numri 0685090450, figuron i regjistruar në emër të shtetasit Franc Grishaj, ID-307398873, dhe nr.0686882222, figuron në emër të shtetasit Besmir Hysaj, ID-294580040.

Gjithashtu, ne këtë shkresë na janë sjellë nga TelekomAlbania edhe një tabelë me të dhënat për numrat e regjistruar në mër të Mikel Livalli, Ndue Pepaj, dhe Sokol Prendi.

Sa me siper meqenese nga rezultatet e deritanishme të hetimeve rezulton se shtetasit e mëposhtëm

1. **Ndue Pepaj**, i biri i Vasel dhe i File, i datëlindjes 06.07.1989, lindur dhe banues në Hot te Bashkisë Malësi e Madhe, aktualisht i arrestuar në Republikën e Malit të Zi, për trafikim narkotikësh,
2. **Gjergj Tatiqaj**, i biri i Kol dhe i Diell, i datëlindjes 30.10.1963, lindur në Goraj-Shkodër dhe banues në Britaninë e Madhe.
3. **Mikel Livalli**, i biri i Pale dhe i Age, i datëlindjes 20.06.1972, lindur në Ndreaj-Shkodër dhe banues në Hot Shkoder.

REPUBLIKA E SHQIPERISË PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR SEKRETARIA

4. **Luçe Livalli**, e bija e Vasel dhe e File, e datëlindjes 01.05.1981, lindur dhe banuese në në Hot Shkoder.

jane te perfshire ne bashkepunim me njeri tjetrin aktivitetin kriminal te pastrimit te produkteve te vepres penale dhe veprimtarise kriminale duke

- transferuar pasuritë e paluajtshme te ndertuara nga shtetasi Ndue Vasel Pepaj, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt veprimtarisë kriminale te kryer nga shtetasi i mesiperm;
- fshehur dhe mbuluar burimin, disponimin, zhvendosjen e pronësisë dhe të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprimtarisë kriminale te kryer nga shtetasi Ndue Vasel Pepaj ;
- fituar pronësisë, poseduar dhe përdorur ate, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprimtarisë kriminale te kryer nga shtetasi Ndue Vasel Pepaj;
- investuar në veprimtari ekonomike dhe financiare para, duke ditur se janë produkte të veprimtarisë kriminale te kryer nga shtetasi Ndue Vasel Pepaj;

Në rastin konkret ka të dhëna të mjaftueshme për të dyshuar se ndodhemi para kryerjes së vepres penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 287 të K.Penal.

Disponimi i lirë i këtyre pasurive mundë të rëndojë pasojat e vepres penale, pasi mundë të tjetërsohen duke u shitur tek përsona të tjerë, duke zgjatur ose rëndojë pasojat e vepres penale.

Për këtë arsye, mbështetur në kërkesat e nenit 274 të K.Pr.Penale,

## K Ë R K O J

Vendosjen e sekuestros preventive të këtyre pasurive:

1. Pasurinë Nr.**120/2, ZK-1989**, truall+ndertese, me siperfaqe totale **600 m²,** nga e cila **ndertese 315,5 m²,** dy katëshe, godinë e kombinuar banimi dhe social ekonomike, një kat banim me sip **188.6m²** dhe një kat për aktivitet ekonomik me sip **315.5 m²**, e regjistruar në emër të shtetasit Gjergj Kol Tatiqaj, e ndodhur në fshatin Ivanaj, bashkia Malësi e Madhe, me regjistrim fillestar në bazë të Lejes së Legalizimit.
2. Pasurinë Nr.**120/3, ZK-1989**, pemtore me sipërfaqe **4707 m²**, e ndodhur në Ivanaj, Malësi e Madhe, e shitur nga Ndue Pepaj dhe e blerë nga Mikel Livalli, me kontartë nr.4130 rep dhe 2866 kol, datë 28.07.2015, para notere Valbona Hajdari, Shkodër.
3. Pasurinë **Nr. 120/4, ZK 1989,** truall+ ndertese me **siperfaqe 89.9 m²**, godinë social-ekonomike një kat, e regjistruar në emër të shtetasit Gjergj Kol Tatiqaj, e ndodhur në fshatin Ivanaj, bashkia Malësi e Madhe, me regjistrim fillestar në bazë të Lejes së Legalizimit.
4. Pasurinë **Nr. 120/5, ZK- 1989,** truall+ ndertese 1 kat me **siperfaqe 37.8 m** 2, në emër të shtetasit Gjergj Tatiqaj, godinë një katëshe social-ekonomike, e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR SEKRETARIA

ndodhur në fshatin Ivanaj, bashkia Malësi e Madhe, me regjistrim fillestar në bazë të Lejes së Legalizimit.

5. Pasurinë me nr.**120/6, ZK-1989**, pemtore me sipërfaqe **4579.3 m$^2$**, e regjistruar në emër ë shtetasit Gjergj Kol Tatiqaj, e ndodhur në fshatin Ivanaj, bashkia Malësi i Madhe.
6. Pasurinë me nr.**118/1, ZK-1989**, pemtore me sipërfaqe **1088 m$^2$**, e regjistruar në emër ë shtetasit Gjergj Kol Tatiqaj, e ndodhur në fshatin Ivanaj, bashkia Malësi i Madhe.
7. Pasuria me nr.**729/4, ZK-1964**, pemtore më sipërfaqe **4510 m$^2$,** e ndodhur në Hot, Malësi e Madhe, e regjistruar në emër të Ndue Vasel Pepaj.

Kjo pronë është ndarë nga pauria nr.**729/2, ZK-1964,** në pronësi të shtetit, sipas urdhrit nr.01, datë 23.10.2014, të Regjistruesit të ZVRPP, M.Madhe.

Duke bërë shënimet perkatëse në Kartelat e Pasurive të Paluajtshme(KPP-të) në ZVRPP, Malësi e Madhe.

Bashkëlidhur kësaj kërkesë kopje të akteve hëtimore të fashikullit të procedimit penal nr.108/2018, mbi bazen e të cilave e mbështesim këtë kërkesë.

Shkodër më 10.05.2018

PROKURORI

ASTRIT HALILAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR SEKRETARIA